



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1429 Prot.

Korçë, më 03/09/2019

VENDIM

Nr. 431, datë 03.09.2019

“PËR

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 764, DATË 21.12.2018, “PËR MIRATIMIN E  
TARIFAVE TË AKTIVITETEVE SHKENCORE”, TË BORDIT TË  
ADMINISTRIMIT”**

Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 03/09/2019, pasi mori në shqyrtim dhe diskutoi në lidhje me shkresën nr. 1415 prot., datë 02.09.2019, “Propozim për një ndryshim në Vendimin nr. 764, datë 21.12.2018, “Për miratimin e tarifave të aktiviteteve shkencore”, të Bordit të Administrimit, paraqitur nga Rektori i Universitetit, në të cilën, në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në nevojat e shprehura nga njësitë kryesore dhe njësitë bazë, propozohet përjashtimi nga tarifat për pjesëmarrje në veprimtaritë shkencore të anëtarëve të Bordit Shkencor, anëtarëve të Bordit organizues, personaliteteve të ftuara, si dhe drejtuesve të institucionit, bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pikat 1 dhe 3/a dhe neni 47, si dhe në propozimin e mësipërm,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin e Rektoratit të Universitetit paraqitur Bordit të Administrimit me shkresën nr. 1415 prot., datë 02.09.2019, “Propozim për një ndryshim në Vendimin nr. 764, datë 21.12.2018, “Për miratimin e tarifave të aktiviteteve shkencore”, të Bordit të Administrimit.
2. Pas pikës 2, të Vendimit nr. 764, datë 21.12.2018, “Për miratimin e tarifave të aktiviteteve shkencore”, të Bordit të Administrimit të shtohet pika 2/1 me përmbajtje si vijon:

*2/1. "Përrjashtohen nga tarifrat për pjesëmarrje në veprimtaritë shkencore anëtarët e Bordit Shkencor, anëtarët e Bordit organizues, personalitetet e ftuara, si dhe drejtuesit e institucionit."*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Prof. as. Mamica Nene**

